



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .07.2024

**MBLEDHJA Nr. 26,**  
**Datë 19.07.2024, ora 08:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 19.07.2024, ora 08:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 26 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 16.07.2024.
2. Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Nova Prospect” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC “Dragobia” dhe HEC “Ceremi”.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**